



03/Nr. 5514/2023
Data: 05.07.2023

PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 23.06.2023 në Sallën e Takimeve të Komunës së Hanit të Elezit. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 15:00 prezent ishin 11 qytetarë të Komunës së Hanit të Elezit.

Takimin e kryesoj Drejtoresha e Administratës znjsh. Natyra Kalisi.

Rendi i Punës

1. Draft Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunës së Hanit të Elezit.

Natya Kalisi:- para se me filluar me prezantimin e Draft Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare fillimisht ftoj Kryetarin e Komunës që ta merr fjalën.

Mehmet Ballazhi:- ne po mundohemi të gjithë mekanizmat dhe hapësirat institucionale me i shfrytëzuar për me i informuar qytetarët dhe sa janë të gatshëm me u kyç ata varet prej tyre për shkak se nuk mund të ja imponuar informacionin me zor por ne e kemi obligative për me rrit transparencë në qasjen për informim. Jemi munduar me i krijuar disa mekanizma shtesë në mënyrë që me qenë më të informuar qytetarët.

Natya Kalisi:- faleminderit Kryetar për pjesëmarrjen edhe pse ne prani shumë të vogël të pjesëmarrësve vlen të theksohet se Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 është zhvilluar mbi aspiratat e komunës për të avancuar me hapa të shpejtë duke përfutur nga avantazhet që ofrojnë zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i shtuar i mediave të reja si kanale të komunikimit. Është një strategji që ka tre objektiva.

1. Avancimi i praktikave të komunikimit të brendshëm në administratën komunale
2. Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe ndërveprimit me qytetarë
3. Promovimi i komunës, aktiviteteve dhe aseteve komunale .

Për më detajisht e keni planin para juve, për çdo pyetje e sugjerim mundemi të ju përgjigjemi, këtu është paraparë që të vendosen disa ekrana informativ për qytetarët nëpër të gjitha zonat si formë për rritjen e pjesëmarrjes qytetare.

Amir Bushi është mirë me pasur një numër telefoni te Qendra për Punë Sociale, në mënyrë që qytetarët me u lajmëruar në atë numër e jo në numra privat.

Natya Kalisi a keni edhe ndonjë propozim, për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka ju faleminderit për pjesëmarrje.

Debati përfundoi në ora 15:25.

Procesmbajtësi
Amir Bushi

